

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË /DIVIZ.KUNDËRVAJTJËS/**, me Gjyqtarin Nehat Qelaj dhe sek.juridike Nexhmije Dakaj në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Fatos Fetah Kryeziu nga fshati Bubavec, K.Malishevës, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5, 6 paragrafi 1.3 dhe 9 i ligji nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, si dhe në bazë të nenit 73, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet (LMK) me dt.16.12.2013 mori këtë:

### A K T V E N D I M

**I pandehuri:** Fatos Kryeziu nga i ati Fetah i lindur me datën 10.07.1976 në fshatin Bubavec, K.Malishevës, ku edhe tani jeton, i martuar i ati i pesë (5) fëmijëve, këshilltar në KK Malishevës, gjendjës së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R.Kosovës,

### Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S :

Sepse në afatin prej 01 deri 31 Mars 2012 si zyrtar i lartë publik nuk e deklaroi pasurinë e tij me ç'rast nuk e përmbush obligimin ligjor që parahihet me ligjin nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe në këtë mënyrë nuk i përmbahet nenit 9 të të njëjtit ligj.

-me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni nga neni 5, 6 paragrafi 1.3 dhe 9 i ligji nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë prandaj në bazë të këtyre dispozitave dhe në kuptim të nenit 17 paragrafi 1.3 të të njëjtit ligj si dhe konform nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i njëjti :

### D Ë N O H E T

**Me gjobë në shumën prej shtatëqind euro ( 700 € )**



Obligohet i pandehuri që gjobën e shqiptuar të paguan në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi në xhirollogari të Këshillit Gjyqësor No.1000 4300 7000 0518, në të kundërtën e njëjta do të zëvendësohet me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetegjashtë (36) ditësh duke llogaritur **15 euro** për një ditë burg, po ashtu i pandehuri obligohet që në afat të lartcekur të paguaj **10 €** në emër të paushallit gjyqësor, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohet parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri.

### A R S Y E T I M

Agjensioni Kundër Korrupsionit parashtroi kërkesën nr.01-2147/2012 të datës 15.06.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Fatos Fetah Kryeziu nga fshati Bubavec, K.Malishevës, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5, 6 paragrafi 1.3 dhe 9 i ligji nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Gjyqtari i qështjës caktoi senac për shqyrtimin e kësaj çështje dhe ftoi të pandehurin që me datën 08.04.2013 të paraqitet në gjykatë që të deklarohet në mbrojtjen e tij për kundërvajtjen me të cilën ngarkohet.

 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep. Dep. <b>DPE / DMP</b> Nr. Fila D. q. marica Nr. pages	<b>02</b>	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. <b>03-4546/13</b> Data Datum <b>31.12.2013</b>
PUNISHTINE		

